



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Acceptance			07-05-2021	viti / year
Pranimi / Acceptance				
Pranimi / Acceptance				
Organizimi / Organization	Drejtori / Director	Adresa / Address	Sasia / Quantity	
SKPM/SHK	2284/2021		116	



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.264/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani -kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1684/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 01.04.2021, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.233/2020 të datës 14.08.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: Rruga "Enver Maloku" 32 nr.14, Komuna e Prishtinës, kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë, në çështjen juridike "ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 07.05.2021, mori këtë:

### V E N D I M

- I. SHFUQIZOHET Vendimi i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë i datës 20.07.2020 me numër protokolli:4085.
- II. OBLIGOHET Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë ta rishqyrtojë lëndën e ankuesit sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të datës 01.07.2020 të ish-Sekretarit të Përgjithshëm.
- III. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë që ti ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ndaj ankuesit sipas Plotësim Ndryshimit të Akt Emërimit të datës 22.01.2019 i punësuar në Ministrinë e Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë në pozitën "Drejtor i Departamentit për Rezerva Shtetërore", Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë me datë 01.07.2020 ka kërkuar inicimin e procedurës disiplinore me pretendimet se i njëjti ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë me datë 20.07.2020 ka nxjerrë vendim me numër protokolli: 4085 duke i shqiptuar ankuesit masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil" pa e dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e Komisioni Disiplinor të datës 20.07.2020, në pajtim me dispozita ligjore në fuqi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 20.08.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë. Më datë 27.08.2019 Ministria e Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë ka dërguar përgjigjen në ankesë me dosjen e bashkangjitur të lëndës e cila është protokolluar me numër 1637/2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim që të vendoset në mënyrë meritore për ankesën, bazuar në dispozitat e nenit 11 të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.05.2021 ka mbajtur seancë publike me palët në procedurë.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 14.08.2020 e parashtruar nga ankuesi me numër protokolli 1555/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 05.12.2019 dërguar nga ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm Kopjen e kontratës së datës 24.12.2019 (vetëm faqen e nënshkruar) me "Hib Petrol" ShPK; Raportin javor të punës për datat respektive 02-06.03.2020; E-mailin e datës 17.03.2020 dërguar nga për me korrespondencën; e bashkangjitur prej 2 (dy) faqesh; Autorizimin e datës 17.03.2020 me numër Ref.nr.01; E-mailin e datës 20.03.2020 dërguar nga për me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 (dy) faqesh; Pëlqimin e datës 20.03.2020; E-mailin e datës 13.03.2020 dërguar nga për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej 5 (pesë) faqesh; E-mailin e datës 28.03.2020 dërguar nga për ankuesin; E-mailin e datës 29.06.2020 dërguar nga për E-mailin e datës 23.06.2020 dërguar nga PATRONI KS për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 (dy) faqesh; E-mailin e datës 24.06.2020 dërguar nga për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 (dy) faqesh; Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor të datës 13.07.2020; vendimin me numër protokolli: 4085 të Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë i datës 20.07.2020; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 20.08.2020; Përgjigjen në kërkesë të datës 27.08.2020; Akt emërimit e ndryshuar dhe plotësuar të datës 22.01.2019; Përshkrimin e detyrave të punës për

pozitën Drejtor i Departamentit për Rezervave Shtetërore të Mallrave; Kontratën e datës 29.06.2020 me numër protokolli:3214 në përmbajtje prej 14 faqesh; Kontratën e datës 04.06.2020 me numër protokolli:2603 në përmbajtje prej 3 faqesh; Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor të datës 07.07.2020; Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor të datës 16.07.2020; E-mailin e datës 07.07.2020 dërguar nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 (dy) faqesh; E-mailin e datës 01.07.2020 dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 (dy) faqesh; E-mailin e datës 07.07.2020 dërguar nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ me korrespondencën e bashkangjitur prej 1 (një) faqe; E-mailin e datës 16.07.2020 dërguar nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 (dy) faqesh; Vërejtjen me shkrim të datës 27.11.2018 me numër Ref.02.Nr; Kërkesën e datës 04.08.2020 me numër reference:04/2020; Regjistrin e vijueshmërisë në punë për ankuesin prej datës 01.01.2019 deri me datë 02.07.2020; Vendimin e datës 13.07.2020 me numër Ref.02/Nr.163 të Sekretarit të Përgjithshëm; Aktgjykimin A.nr.1684/2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 01.04.2021; Ftesat për seancë publike të datës 29.04.2021 me numër protokolli 2070/2021 dërguar për ankuesin dhe përfaqësuesit e ministrisë; Procesverbalin e seancës publike të mbajtur me datë 05.05.2021 në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ekziston baza ligjore që lënda e ankuesit të kthehet në *rishqyrtim*, duke e obliguar Komisionin Disiplinor të Ministrisë së Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë që të bëjë rishqyrtimin e kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit të datës 01.07.2020, *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, se Komisioni Disiplinor të Ministrisë së Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër protokolli: 4085 të datës 20.07.2020 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative pasi që vendimi si i tillë nuk i plotëson kriteret e parapara formale të akti administrativ, mungon arsyetimi dhe në vetvete është kundërthënës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër protokolli: 4085 të datës 20.07.2020 ankuesit i ka shqiptuar masa disiplinore "Largimi nga Shërbimi Civil" për shkak të konstatimit se i njëjti ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës me rastin e nënshkrimit të dy (2) kontratave, respektivisht nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik "Patroni SHPK" të datës 29.06.2020 dhe asaj me "Ada Group SHPK & Kajmak SHPK" të datës 04.06.2020, pa autorizimin dhe pëlqimin paraprak nga titullari i institucionit-ministri i Ministrisë së Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë siç është e përcaktuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-244 për Rezervat Shtetërore.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 87 paragrafi 1 i cili përcakton se: "*Nëpunësi civil shkarkohet nga shërbimi civil për shkak të performancës dhe rezultateve të dobëta, shkeljes së kodit të*



mirësjelljes dhe shkeljes së ligjit, i cili ka rezultuar me veprë penale, siç është përcaktuar me këtë ligj.", si dhe neni 66 paragrafi 1 dhe 2, i të njëjtit ligj cilët përcaktojnë se: "1.Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e nëpunësit civil. Rastet e shkeljeve jashtëzakonisht të rënda përcaktohen me akt nënligjor" si dhe "2. Shkeljet e detyrave të punës ndahen në: shkelje të lehta dhe shkelje të rënda – serioze të cilat do të rregullohen me akt nënligjor " si dhe dispozitat e Rregullores nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, neni 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10i cili përcaktojnë se: ..."Shkelje të rënda-serioze konsiderohen: shkelja e detyrave të punës që kanë pasojat për palën dhe organin shtetëror", si dhe neni 8 paragrafi 1, nën paragrafët 1.1; 1.2, 1.3; 1.4 dhe 1.5 i të njëjtës rregulloreje të cilët përcaktojnë se: " Për shkelje të rënda-serioze të përcaktuara me nenin 6 të kësaj rregulloreje, nëpunësit civil, mund t'i shqiptohen këto masa disiplinore: 1.1 pezullimi parandalues me pagesë deri në (3) muaj në pritje të një hetimi, i cili duhet të propozohet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe miratohet nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit në institucion; 1.2 pezullimi i ushtrimit të detyrave dhe ndalimi i 1/3 së rrogës për një periudhë deri në dy (2) muaj nga komisioni disiplinor pas kërkesës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë; 1.3 largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vjet nga komisioni disiplinor; 1.4 ndërprerja e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil nga komisioni disiplinor, pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension; dhe 1.5 pensionim i parakohshëm i nëpunësve civil, të cilëve u kanë mbetur edhe dy (2) vjet deri në datën e pensionimit", andaj mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se masa disiplinore "ndërprerje e marrëdhënies së punës" e cila i është shqiptuar ankuesit Arton Muçaj është masa më e rëndë disiplinore që shqiptohet në shërbimin civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë si dhe gjatë deklarimeve të palëve në procedurë në seancën publike të mbajtur nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 06.05.2019, Kolegji ka konstatuar se në pikën II të dispozitivit të vendimit të Komisionit disiplinor të datës 20.07.2020 është specifikuar se ankuesi ka bërë shkelje të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publik respektivisht neni 46 nën paragrafi 2.1, nën paragrafi 3.1; 3.3 dhe 3.10 të cilat përcaktojnë se: "Shkeljet disiplinore; 2.1. shkelje të rënda; 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale dhe 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi", mirëpo Komisioni Disiplinor nuk ka arritur të arsyetojë mjaftueshëm vendimin, siç përcaktohet me nenin 48 paragrafi dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative : "Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërtshënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij", ngase Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së vendimit të datës 20.07.2020 nuk ka arritur të arsyetojë se cili veprim apo mosveprim i ankuesit paraqet mos përmbushje të detyrave të punës në rastin konkret, andaj me këtë rast pretendimi i ankuesit sa i përket pjesës së arsyetimit të vendimit është i bazuar dhe se arsyetimi i dhënë është dukshëm i pamjaftueshëm.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës si dhe deklarimeve në seancën publike të mbajtur nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 06.05.2019, si dhe pretendimeve të ankuesit të paraqitura në seancën disiplinore të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë të datës 13.07.2020, Kolegji vlerëson se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së vendimit të datës 20.07.2020 nuk ka ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për të vërtetuar pretendimet e ankuesit se i njëjti me rastin e nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik "Patroni SHPK" të datës 29.06.2020 dhe asaj me "Ada Group SHPK & Kajmak SHPK" të datës 04.06.2020, pretendon se nuk i ka tejkualuar autorizimet ligjore siç është e përcaktuar në Ligjit Nr.03/L-244 për Rezervat Shtetërore, si dhe pretendimet e ankuesit se pse nuk ka qenë i njoftuar nga Sekretari i Përgjithshëm pasi që i njëjti ka nënshkruar kontrata të reja, përderisa ankuesi në cilësinë e Drejtorit të Departamentit për Rezerva Shtetërore nuk është njoftuar zyrtarisht përkundër kërkesave të tij, respektivisht kërkesë-njoftimit të dërguar përmes e-mailit të datës 05.12.2019 që të shqyrtohet mundësia e vazhdimit apo lidhjeve të kontratave të reja më qëllim të ruajtjes së rezerva shtetërore, andaj me këtë rast Kolegji konstaton se është nevojshme që lënda e ankuesit të kthehet në rishqyrtim tek Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë sepse nuk ka arritur të vërtetohet mjaftueshëm gjendjen faktike.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë, është i obliguar që të rishqyrtoj edhe një herë rastin e ankuesit sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të bërë nga Sekretari i Përgjithshëm të datës 01.07.2020 dhe pas administrimit të gjithave provave të lëndës të marrë vendim meritore të bazuar në faktet dhe provat e lëndës si dhe të ushtrij kompetencat të cilat ia sigurojnë dispozitat ligjore në fuqi duke kërkuar prova të reja eventuale brenda institucionit dhe palëve në procedurë.

Po ashtu, Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë duhet ta ketë parasysh aplikimin e drejtë të së drejtës materiale.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *"Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës"*, dhe me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të po këtij ligji është përcaktuar se: *"Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit."*

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit



**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.264/2021**

**Flakron GASHI**



*Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional*



**Eshtref SHABANI**

*Kryetar i Kolegjit*

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesi,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së

